



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2819/3 prot.,

Datë 20.12.2022

**FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Dajti Park 2007” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-45637-10-12-2022, me objekt: “*Zgjerimi i hapësirave të varrezave publike Tufinë*” me fond limit 91.666.666,66 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 28.10.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

Ankimues: “Dajti Park 2007” SHPK
Rruga “Bardhok Biba”, Pallati TREMA, Hyrja C, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Tiranë
Sheshi “Skënderbej”, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë

Në datën 19.12.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. protokolli 2819/2022 datë 19.12.2022 e operatorit ekonomik “Dajti Park 2007” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-45637-10-12-2022, me objekt: “*Zgjerimi i hapësirave të varrezave publike Tufinë*” me fond limit 91.666.666,66 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 28.10.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Dajti Park 2007” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Dajti Park 2007” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. protokollit 2819/2022 datë 19.12.2022.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

Operatori ekonomik ka deklaruar si mbeshtetes me kapacitete ne kete procedure prokurimi “Pastrime Silvio” shpk nuk përmbush Kriteret e Pergjitheshme te Kualifikimit, ku percaktohet se: “Këto kriteret duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8”. Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, i paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit, rezulton se operatori ekonomik “Pastrime Silvio” Shpk nuk ka deklaruar “Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, që nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.”, konkretisht nuk është deklaruar Administratori z. Gani Deliu.

Operatori ekonomik Dajti Park 2007 Shpk nuk përmbush kerkesat e pikes 2.3 te Krieteve te Vecanta te Kualifikimit, ku percaktohet se: “Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën: Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit ose Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet të realizuar gjatë pesë viteve të fundit”, pasi për përmbushjen e punës së ngjashme, janë paraqitur kontratat “Rikonstruksion Shkolla e Mesme Ymer Lala, Surrel”, “Rikonstruksion disa QSH në qarqet Tirane dhe Durres, Loti I”, “Rikonstruksion I 5 godinave ekzistuese dhe ndertimi I sistemit të ngrohjes, të cilat nuk konsiderohen punë e ngjashme me objektin e prokurimit “Zgjerimi i hapsirave të varrezave publike Tufine”. Ndërsa kontratat e deklaruar me objekt “Ndertim i rrugeve Klenje, Fajza, Paralel me Bushtricen, Gryka e Cajc, Bathore 1-2”, me vlerë ndërtimi sipas Marreveshjes së Bashkëpunimit 16,939,862.5 lekë pa TVSH,

“Sistemim asfaltim i rruges Hasrameve dhe Taruceve dhe KUZ, rruga Taruceve, Mucaj, Bashkia Vore” me vlerë ndërtimi sipas Marreveshjes se Bashkepunimit 19,669,417.99 lekë pa TVSH dhe “Rikonstruksion I rruges Kadri Kerciku” me vlerë ndërtimi sipas Marreveshjes se Bashkepunimit 25,214,044.32 lekë pa, nuk pëmbushin asnjëren nga kërkesat e pikës 2.3 të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit në lidhje me vlerën që është kerkuar për punë të ngjashme në DST, pasi vlera totale e punëve të ngjashme të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit është 61,823,324.81 leke pa TVSH.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 20.12.2022.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri